



# Të kuptoni certifikatën e sigurimeve të pensionit (Vorsorgeausweis)

Kjo fletë udhëzuese ju paraqet, sesi është ndërtuar një certifikatë e sigurimeve të pensionit. Ajo jep sqarime dhe përmban informacione të dobishme për tema të rëndësishme.

Paragrafët me numra u referohen secili seksioneve në modelin e certifikatës së sigurimeve të pensionit. Ju lutemi vini re, që modeli i certifikatës së sigurimeve të pensionit mbulon të gjitha zgjidhjet për pension të fondacioneve kolektive, të drejtuara nga Swiss Life. Nëse keni pyetje konkrete për zgjidhjen tuaj për pension, përcaktimet i gjeni në rregulloren e sigurimeve të pensionit.

## 1 Të dhëna të përgjithshme (Allgemeine Angaben)

Këtu tregohen të dhënat mbi kontratën dhe personin tuaj. **Paga vjetore e deklaruar (gemeldeter Jahreslohn)** si rregull përkon me pagën vjetore AHV të deklaruar nga punëdhënësi juaj dhe duhet të përputhet me pagën tuaj vjetore efektive (paga bruto sipas vërtetimit të pagës).

Paga vjetore duke hequr zbritjen e koordinimit jep pagën e siguruar. Zbritja e koordinimit shërben për koordinimin me kolonën e parë (Sigurimet e detyrueshme federale për pension pleqërie dhe për pension për persona të lënë pas AHV).

## 2 Depozita e pleqërisë (Altersguthaben)

**Depozita** juaj **ekzistuese e pleqërisë (vorhandenes Altersguthaben)** llogaritet me ditë të sakta dhe është e vlefshme për datën e lëshimit. Ajo përmban kontributet vjetore të kursimit, shumat e kalimit të lirë të transferuara, interesat si edhe blerjet dhe kontribute të çfarëdo lloji tjetër (p.sh. tepricat).

Nëse ndërpritni marrëdhëniet tuaja të punës, ju gëzoni **të drejtën e kalimit të lirë (Freizügigkeitsanspruch)**. Shuma i përcillet institutit të sigurimeve të punëdhënësit tuaj të ri. Mundësitë për rastin që nuk filloni një punë të re, i gjeni në fletën udhëzuese «Austritt» (Dalja) nën linkun te certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

Për pagesën e interesit për paratë tuaja të sigurimeve të pensionit vlejné normat e interesit të dhëna te certifikata juaj. Normat e interesit për pjesën e detyrueshme përcaktohen çdo vit nga Kuvendi Federal, pagesa e interesit për shumën e depozituar mbi pjesën e detyrueshme përcaktohet - sipas zgjidhjes për pension - nga këshilli i fondacionit ose nga komisioni administrativ.

## 3 Përfitimet në moshën e pensionit (Leistungen im Alter)

Kur dilni në pension, si rregull keni mundësi zgjedhjeje midis pensionit të pleqërisë që zgjat gjithë jetën, derdhjes njëherësh të të gjithë kapitalit të grumbulluar ose një kombinimi të të dyjave.

Ju shikoni **kapitalin (Kapital)** e parashikuar ose **pensionin (Rente)** e parashikuar në momentin e daljes së rregullt në pension ose në momentin e daljes së parakohshme në pension. Kapitali i parashikuar llogaritet me përafërsi me të dhënat që njihen sot (depozita ekzistuese e pleqërisë, paga e siguruar, kontributet vjetore për pension pleqërie dhe kohëzgjatja e sigurimit deri në dalje në pension). Interesi i projektimit i përdorur për llogaritjen e përafërt orientohet sipas normës efektive të interesit të shumëzës së depozituar për pension pleqërie në vitet e fundit dhe po ashtu është i shënuar në certifikatë. Kapitali përbën bazën për llogaritjen e pensionit të pleqërisë.

Norma e konvertimit është vendimtare për vlerën e pensionit. Pensioni llogaritet nga shumëzimi i kapitalit me normën e konvertimit. Në rastin e lënies së parakohshme të punës, norma e konvertimit zvogëlohet dhe për pasojë edhe pensioni. Pensionin e pleqërisë ju e merrni pas daljes në pension deri në fund të jetës suaj.

Veç pensionit të pleqërisë jepen edhe **pensionet e fëmijëve të personit në pension (Pensionierten-Kinderrenten)**, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve për pensionin. Një pension për fëmijë ju e merrni pas daljes suaj në pension për çdo fëmijë të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç). Gjithashtu janë të siguruar edhe përfitimet për personat e lënë pas për bashkëshortët/partnerët bashkëjetues dhe fëmijët.

#### **4 Financimi i daljes së parakohshme në pension (Finanzierung vorzeitige Pensionierung)**

Në rast se vendosni për të dalë para kohe në pension, këtu shikoni maksimumin e mundshëm të *Shumës së blerjes për një pension të parakohshëm (Einkaufssumme für eine vorzeitige Pensionierung)*. Duke derdhur këtë shumë, mund të siguroheni, që edhe në rast të daljes para kohe në pension të merrni pensionin e plotë. Ju lutemi vini re, që këto informacione dalin vetëm pas shfrytëzimit të plotë të pjesës së mbetur të potencialit tuaj të blerjes (shikoni Nr. 7).

#### **5 në rast invaliditeti (Leistungen bei Invalidität)**

Ju e merrni të plotë *pensionin vjetor të invaliditetit (jährliche Invalidenrente)* kur, sipas sigurimit federal të invaliditetit, jeni invalid të paktën në masën 70% dhe afati i pritjes ka skaduar.

Në rastin e invaliditetit të pjesshëm, shuma e përfitimeve të invaliditetit përcaktohet duke marrë në konsideratë shkallën e invaliditetit sipas rregullores së sigurimeve të pensionit. Përfitimet fillojnë tashme nga shkalla e invaliditetit prej 25%.

Për çdo fëmijë ju merrni të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës, deri në moshën 25 vjeç) një *pension për fëmijën e personit invalid (Invaliden-Kinderrente)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

*Çlirim nga detyrimi i pagesës së kontributeve (Beitragsbefreiung)* do të thotë, që ju dhe punëdhënësi juaj, në rastin e invaliditetit dhe pas skadimit të afatit të pritjes, nuk duhet të paguani më asnjë kontribut. Përfitimet tuaja të pensionit të pleqërisë, të pensionit për personat e lënë pas dhe të pensionit të invaliditetit vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën masë.

#### **6 Përfitimet në rast vdekjeje para daljes në pension (Leistungen bei Tod vor der Pensionierung)**

Në rastin e vdekjes së personit të siguruar, për personin bashkëjetues dhe partnerin homoseksual janë të vlefshme të njëjtat kushte si për çiftet e martuara dhe të regjistruara, nëse jetesa së bashku në një shtëpi ka ekzistuar të paktën për pesë vjetet e fundit përpara vdekjes së personit të siguruar dhe nëse duhet kujdesur për fëmijët e përbashkët. Vendimtare janë përcaktimet e rregullores së sigurimeve të pensionit të vlefshme në momentin e vdekjes. Në vend të *pensionit të bashkëshortit ose të partnerit (Ehegatten- bzw. Partnerrente)*, bashkëshorti juaj ose personi juaj bashkëjetues mund të kërkojë marrjen e plotë ose të pjesshme të kapitalit.

Çdo fëmijë me të drejtë përfitimi merr të paktën deri në moshën 18 vjeç (në rastin e ndjekjes së shkollës,

deri në moshën 25 vjeç) një pension *për fëmijët jetimë (Waisenrente)*, nëse ky përfitim është parashikuar në planin e sigurimeve të pensionit.

#### **7 Blerja dhe kthimet (Einkauf und Rückzahlungen)**

Shumica e personave të siguruar zotërojnë një potencial për blerje në shtyllën e dytë. Me këtë arrini përfitimet më të larta ose ndoshta maksimale nga sigurimet e pensionit. Vini re, që blerjet mund të kryhen, sipas ligjit, vetëm kur janë kthyer tërheqjet e parakohshme për pronësinë e banesës.

Informacione të tjera të dobishme për *Blerjen dhe kthimet (Einkauf und Rückzahlungen)* dhe kushtet e përgjithshme ligjore i gjeni në fletën udhëzuese «Einkauf» (Blerja) nën linkun të certifikata juaj e sigurimeve të pensionit (shikoni Nr. 11).

#### **8 Financimi (Finanzierung)**

Me punëdhënësin tuaj financoni përfitimet e siguruar. Punëdhënësi juaj e zbret kontributin tuaj mujor nga paga juaj bruto. Diferencën me totalin e paguan punëdhënësi juaj.

*Kontributi i kursimeve (Sparbeitrag)* (pjesa e kontributit për përfitimet e pleqërisë) ndikon direkt mbi depozitën e pleqërisë. Me *Kontributet për rreziqet (Risikobeiträge)* do të financohen përfitimet e siguruar në rast invaliditeti dhe vdekjeje.

#### **9 Informacione të përgjithshme (Allgemeine Informationen)**

*Tërheqja e parakohshme maksimalisht e mundshme për pronësinë e banesës (maximal möglicher Vorbezug für Wohneigentum)* përkon deri në moshën 50 vjeç me të drejtën përkatëse të kalimit të lirë. Pas kësaj moshe, mund të tërhiqet ose gjysma e së drejtës aktuale të kalimit të lirë, ose e drejta e kalimit të lirë për moshën 50 vjeçare, në varësi se cila shumë është më e madhe.

#### **10 Komisioni administrativ (Verwaltungskommission)**

Pjesëtarët e komisionit administrativ marrin përsipër në mënyrë të veçantë vënien në zbatim të rregullores së sigurimeve të pensionit, informimin e personave të siguruar dhe zgjedhjen e pjesëtarëve të këshillit të fondacionit.

#### **11 Shënime (Bemerkungen)**

Informacione të mëtejshme, në mënyrë të veçantë rregulloren e sigurimeve të pensionit dhe kushtet e vlefshme aktuale, i gjeni nën linkun e dhënë. Pyetjet tuaja në lidhje me sigurimet të pensionit mund t'i diskutoni direkt me këshilltarin tuaj për klientin, dhe ai është i gatshëm t'ju këshillojë me kënaqësi.

BVG-Sammelstiftung Swiss Life  
Mustermann AG, Musterstätten



CH/UXX-PXSX / XXXXXX / 756.XXXX.XXXX.XX

**Persönlich/Vertraulich**

Frau  
Sabine Muster



**Persönlicher Vorsorgeausweis  
für Frau Sabine Muster**

**gültig ab 01.02.2019**

Erstellungsgrund: Eingang Freizügigkeitsleistung

**Aktiver Teil**

Alle Beträge in CHF

① <b>Allgemeine Angaben</b>	Vertrag Nr. XXXXXX	Gemeldeter Jahreslohn	45'480.00
	Versichertengruppe 001 - Allg. Bestand	Anrechenbarer Lohn Sparteil	33'142.50
	Allgemeiner Bestand	Anrechenbarer Lohn Risikoteil	45'480.00
	Versicherten-Nr. 756 XXXX.XXXX.XX		
	Geburtsdatum 28.03.1961		
	Beschäftigungsgrad 50.00%		

		obligatorischer Teil	Total
② <b>Altersguthaben</b>	Vorhandenes Altersguthaben am 01.01.2019	13'352.10	76'057.65
	Zinsgutschrift vom 01.01.2019 bis 01.02.2019	13.90	53.15
	Einlage (Freizügigkeitsleistung) 01.02.2019	0.00	75'900.65
	Altersgutschrift vom 01.01.2019 bis 01.02.2019	312.10	497.15
	Altersguthaben am 01.02.2019	13'678.10	152'508.60
	Freizügigkeitsanspruch am 01.02.2019	13'678.10	152'508.60
	Gültiger Zinssatz für die betroffene Periode		
	• für den obligatorischen Teil:	x.xxx%	
	• für den überobligatorischen Teil:	x.xxx%	

		Kapital	oder	Rente
③ <b>Leistungen im Alter</b>	Im Alter 64 am 01.04.2025	206'774.75		11'201.25
	Im Alter 63 am 01.04.2024	197'355.40		10'363.90
	Im Alter 62 am 01.04.2023	188'098.00		9'589.80
	Im Alter 61 am 01.04.2022	178'999.90		9'102.60
	Im Alter 60 am 01.04.2021	170'058.25		8'658.80
	Im Alter 59 am 01.04.2020	161'270.35		8'253.10
	Im Alter 58 am 01.04.2019	153'704.90		7'911.60
	Weitere Leistungen im Alter (in Prozent der in Rentenform bezogenen Altersleistung)			
	• Pensionierten-Kinderrente 20%			
	• Ehegatten-/Partnerrente bei Tod nach Pensionierung 60%			
	• Waisenrente bei Tod nach Pensionierung 20%			
	Für die Berechnung der Altersleistungen angenommener Zinssatz (nicht garantiert): x.xxx%			
	Die für die Umwandlung des Altersguthabens in eine Rente massgeblichen Sätze sowie die aktuell gültigen Zinssätze finden Sie unter <a href="http://www.swisslife.ch/protect/">www.swisslife.ch/protect/</a>			

④ <b>Finanzierung vorzeitige Pensionierung</b>	Einkaufssumme für vorzeitige Pensionierung	Maximal
	Im Alter 63 am 01.02.2024	15'357.55
	Im Alter 62 am 01.02.2023	30'737.60
	Im Alter 61 am 01.02.2022	40'323.65
	Im Alter 60 am 01.02.2021	49'105.70
	Im Alter 59 am 01.02.2020	57'128.00
	Im Alter 58 am 01.04.2019	64'056.70
	Bezüglich Finanzierung verweisen wir auf das Vorsorgereglement	

## Muster Vorsorgeausweis 2019: Rückseite

Vertrag XXXXXX Versicherten Nr. 756.XXXX.XXXX.XX  
 Frau Sabine Muster, geboren am 28.03.1961

Alle Beträge in CHF

		bei Unfall	bei Krankheit
<b>5 Leistung bei Invalidität</b>	Jährliche Invalidenrente (Wartefrist 24 Monate)	0.00	15'918.00
	Jährliche Invaliden-Kinderrente (Wartefrist 24 Monate)	0.00	502.20
	Beitragsbefreiung (Wartefrist 3 Monate)		
	Die ausgewiesenen Leistungen entsprechen einem Invaliditätsgrad von 100% Die Leistungen bei Invalidität sind längstens bis 31.03.2025 zahlbar.		
<b>6 Leistung bei Tod vor der Pensionierung</b>	Jährliche Ehegatten-/Partnerrente	0.00	1'506.55
	Jährliche Waisenrente	0.00	502.20
	Todesfallkapital zusätzlich zu einer Ehegatten- / Partnerrente	152'508.60	119'333.25
	Todesfallkapital wenn keine Ehegatten- / Partnerrente fällig wird	152'508.60	152'508.60
<b>7 Einkauf / Rückzahlung</b>		obligatorischer Teil	Total
	Total mögliche Einzahlung per 01.02.2019	0.00	0.00
	• Anteil Rückzahlung Vorbezüge Wohneigentum	0.00	0.00
	• Anteil Rückzahlung infolge Scheidung/Auflösung der eingetragenen Partnerschaft	0.00	0.00
	• Anteil Einkauf in die Pensionskasse		0.00
Vorbezüge für Wohneigentum sind vor einem Einkauf zurückzuerstatten.			
<b>8 Finanzierung</b>		Arbeitnehmer	Total
	Sparbeitrag	2'971.20	5'942.40
	Risiko-, Kosten- und gesetzlich vorgeschriebene Zusatzbeiträge	622.80	1'245.60
	Jahresbeitrag Monatsbeitrag 1/12	3'594.00 299.50	7'188.00 599.00
<b>9 Allgemeine Informationen</b>		obligatorischer Teil	Total
	Freizügigkeitsleistung im Alter 50		50'723.55
	Maximal möglicher Vorbezug für Wohneigentum per 01.02.2019 Verpfändung für Wohneigentum: nein		50'723.55
<b>10 Verwaltungskommission</b>	Präsident/Präsidentin Hans Meier		
	Arbeitnehmervertretende Max Muster	Arbeitgebervertretende Hans Meier	
<b>11 Bemerkungen</b>	Weitergehende Informationen finden Sie unter: <a href="http://www.swisslife.ch/protect/">www.swisslife.ch/protect/</a>		
	Die aufgeführten Werte basieren auf heute geltenden Annahmen und haben rein informativen Charakter.		
	Bezüglich Fälligkeit und Anspruchsberechtigung der Leistungen verweisen wir auf Ihr Vorsorgereglement und den Vorsorgeplan, die die Grundlage dieses Vorsorgeausweises bilden. Bei Fragen wenden Sie sich bitte an Vorname Nachname, Tel. 043 284 XX XX.		
<b>Ihre Vorsorge online</b>	Mit dem Onlineportal überblicken Sie Ihre Vorsorgedaten und können Ihre finanzielle Zukunft online planen. Melden Sie sich noch heute unter <a href="http://myworld.swisslife.ch">myworld.swisslife.ch</a> an und profitieren Sie von unseren Dienstleistungen.		
Erstellt von Swiss Life am 15.01.2019 im Auftrag Ihrer Vorsorgeeinrichtung.			